

**FORMULAR I DEKLARIMIT DHE
PAGESËS SË TAKSËS SË RENTËS
MINERARE**



Numri i Vendosijes së Dokumentit (NVD)

(Vetëm për përdorim zyrtar)

(2) Periudha tatimore

(1) Numri Serial: _____

Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm (NIPT):	(3) _____
Emri Tregtar i Personit të Tatueshëm:	(4) _____
Emri Mbiemri i Personit Fizik:	(5) _____
Adresa:	(6) _____
Qyteti/Komuna/Rrethi :	(7) _____
Numri Telefonit:	(7) _____

Lajmëroni nëse informacioni i mësipërm është jo i plotë ose ka ndryshuar

I. SHITJE BRËNDA VENDIT NGA ZOTËRUESI I LEJES SË SHFRYTËZIMIT

	<i>Vlera e taksueshme</i>	<i>Vlera totale</i>
[8/9] Shitje e mineralit	[8]	[9]
[10/11] Shitje e nënproduktit	[10]	[11]
<i>Renta e llogaritur</i>		
[12] Renta për shitjen e mineralit	[12]	
[13] Renta për shitjen e nënproduktit	[13]	
[14] Totali për t'u paguar		[14]

II. EKSPORTE NGA ZOTËRUESI I LEJES SË SHFRYTËZIMIT

	<i>Vlera e taksueshme</i>	<i>Vlera totale</i>
[15/16] Eksporte të mineralit	[15]	[16]
[17/18] Eksporte të nënproduktit	[17]	[18]

	<i>Renta e llogaritur</i>	<i>Renta e paguar</i>
[19/20] Renta për mineralin e eksportuar	[19]	[20]
[21/22] Renta për nënproduktin e eksportuar	[21]	[22]
[23/24] Totali i rentës	[23]	[24]

III. EKSPORTE ME TË TRETË , PËR BLERJET NGA ZOTËRUESI I LEJES SË SHFRYTËZIMIT

III/1 Shitje nga zotëruesi i lejes brënda vëndit tek eksportuesi

	<i>Vlera e taksueshme</i>	<i>Vlera totale</i>
[25/26] Shitje të mineralit	[25]	[26]
[27/28] Shitje të nënproduktit	[27]	[28]

	<i>Renta e llogaritur</i>	
[29] Renta për mineralin	[29]	
[30] Renta për nënproduktin	[30]	
[31] Totali i rentës per t'u paguar		[31]

III/2 Eksportet e mineralit të blerë nga zotëruesi i lejes

	<i>Vlera e taksueshme</i>	<i>Vlera totale</i>
[32/33] Eksporte të mineralit	[32]	[33]
[34/35] Eksporte të nënproduktit	[34]	[35]

	<i>Renta e paguar nga zotëruesi i lejes</i>	<i>Renta e paguar në Doganë</i>
[36/37] Renta për mineralin me destinacion eksportin	[36]	[37]
[38/39] Renta për nënproduktin me destinacion eksportin	[38]	[39]
[40/41] Totali i rentës	[40]	[41]

[42]
[43]

[42] Taksë e rentës minerare për t'u paguar [14] + [31]

[44]

[43] Dënime/ interesa për vonesa

[44] TOTALI PËR T'U PAGUAR

Data dhe Firma e Personit të Tatueshëm - Deklaroj nën përgjegjësinë time që informacioni i mësipërm është i plotë dhe i saktë.

PAGESA

Vetëm për përdorim zyrtar
Lekë

Xhirim

Cek

Të tjera:.....

Tatimeve

SHUMA E PAGUAR:

Data, Vula e Bankës dhe nënshkrimi i nëpunësit të bankës. Originali- Zyra e

Kopja-Personi i Tatueshëm

UDHËZUES PËR MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË FORMULARIT TË DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TAKSËS SË RENTËS MINERARE

1. Numri serial gjenerohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe shërben për të azhornuar regjistrimet kur paraqitet deklarata.
 2. Periudha Tatimore është mujore.
 3. Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshëm (NIPT) është numri i dhënë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit/Drejtoria Rajonale Tatimore dhe që identifikon personin e tatueshëm në të gjitha marrëdhëniet me Drejtorinë Rajonale Tatimore.
 4. Emri Tregtar i Personit të Tatueshëm është emri me të cilin paraqitet veprimtaria dhe që shënohet në çertifikatën e NIPT-it.
 5. Emri, Mbiemri i Personit Fizik vendoset kur veprimtaria ekonomike kryhet nga një person fizik dhe nuk ka emër tregtar.
 6. Adresa tregohet për vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë. Kjo adresë është treguar edhe në çertifikatën e NIPT –it.
 7. Numri i Telefonit (n.q.s. ka) tregon numrin e telefonit në vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike.
- I.** Shitjet për konsum final brenda vendit janë shitjet e muajit për të cilin deklarohet, shitje të kryera nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit të mineralit të papërpunuar që ai nxjerr nga sipërfaqja/nëntoka, si dhe shitjet e nënproduktit të prodhuar nga zotëruesi i lejes të shfrytëzimit me mineralin që ai vetë ka nxjerrë nga sipërfaqja/nëntoka.
8. Vlera e taksueshme e mineralit [8] është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet % e rentës, që në rastin e shitjes së mineralit të papërpunuar nga zotëruesi i lejes, për konsum final brenda vendit, është e njëjtë me vlerën totale të shitjeve me rubrikën [9].
 9. Vlera totale e shitjeve të mineralit [9] është totali i shitjeve për konsum final brenda vendit, të kryera nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit, për muajin në të cilin deklarohet, të mineralit të papërpunuar, mbi bazën e çmimeve të tregut, bazuar në faturat e shitjes me TVSH.
 10. Vlera e taksueshme e nënproduktit [10] është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet % e rentës, për nënproduktet e prodhuara nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit (me mineralin që ai vetë nxjerr nga sipërfaqja/nëntoka), të cilat ai i shet për konsum final brenda vendit dhe që është vetëm vlera e mineralit të përdorur për prodhimin e këtyre nënprodukteve. Vlera deklarohet nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit i cili në këtë rast është dhe prodhuesi i nënproduktit, mbi bazën e normativave teknologjike dhe çmimeve të tregut të mineralit të përfshirë në nënprodukt. Ky çmim nuk duhet të jetë më i vogël se çmimi referues i përcaktuar në Raportin e Komisionit AD-HOC. Po ashtu normativat teknologjike mbi të cilat llogaritet minerali i përfshirë në nënprodukt nuk duhet të jenë më të ulta se ato të përcaktuara në raportin e komisionit AD-HOC.
 11. Vlera totale e shitjeve të nënproduktit [11] është totali i shitjeve të kryera nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit, për muajin për të cilin deklarohet, për konsum final brenda vendit, të nënproduktit të prodhuar nga ana e tij (me mineralin për të cilin zbatohet renta minerare dhe që është përfshirë në nënprodukt), bazuar në faturat e shitjes me TVSH.
 12. Renta e llogaritur për shitjen e mineralit [12], tregon rentën që duhet të paguhet nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit për mineralin e papërpunuar të shitur për konsum final brenda vendit, e cila rezulton duke shumëzuar vlerën e taksueshme rubrikën [8] me % e rentës së miratuar për mineralet bazuar në shtojcën 2 të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008, i ndryshuar, për muajin për të cilin deklarohet.
 13. Renta e llogaritur për shitjen e nënproduktit [13], tregon rentën që duhet të paguhet nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit për mineralin që ai vetë ka nxjerr nga sipërfaqja/nëntoka, dhe që e ka përdorur për prodhimin e

nënproduktit të shitur për konsum final brenda vendit, e cila del duke shumëzuar vlerën e taksueshme rubrikën [10] me % e rentës së miratuar për mineralet bazuar në shtojcën 2 të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008, i ndryshuar (si dhe në materialin e komisionit AD-HOC), për muajin për të cilin deklarohet.

14. Totali i rentës për t'u paguar[14], tregon shumën totale të rentës që duhet të paguhet nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit për shitjet për konsum final brenda vëndit dhe rezulton nga shuma e rubrikave [12]+ [13].

II. Eksporte të kryera nga vetë zotëruesi i lejes së shfrytëzimit të mineralit të papërpunuar që ai ka nxjerrë nga sipërfaqja/nëntoka, si dhe eksporte të kryera nga vetë zotëruesi i lejes së shfrytëzimit të nënproduktit të prodhuar prej tij me mineralin, që ai vetë ka nxjerrë nga sipërfaqja/nëntoka.

15. Vlera e taksueshme e mineralit të eksportuar[15] është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet % e rentës, që në rastin e eksporteve nga vetë zotëruesi i lejes të mineralit të papërpunuar është vlera totale e eksporteve të mineralit të papërpunuar, e njëjtë me rubrikën [16].

16. Vlera totale e mineralit të eksportuar [16] është vlera e eksportit të mineralit të papërpunuar nga zotëruesi i lejes për muajin në të cilin deklarohet mbi bazën e çmimeve të eksportit, që është çmimi FOB Shqipëri.

17. Vlera e taksueshme e nënproduktit të eksportuar [17] është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet % e rentës, për nënproduktet e prodhuara nga zotëruesi i lejes të shfrytëzimit (me mineralin që ai vetë nxjerr nga sipërfaqja/nëntoka), të cilat ai i eksporton për muajin për të cilin deklarohet dhe llogaritet vetëm për vlerën e mineralit të përdorur për prodhimin e këtyre nënprodukteve. Vlera deklarohet nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit, mbi bazën e normativave teknologjike dhe çmimeve të mineralit të përfshirë në nënprodukt. Ky çmim nuk duhet të jetë më i vogël se çmimi referues i përcaktuar në Raportin e Komisionit AD-HOC. Po ashtu normativat teknologjike mbi të cilat llogaritet minerali i përfshirë në nënprodukt nuk duhet të jenë më të ulta se ato të përcaktuara në raportin e komisionit AD-HOC.

18. Vlera totale e nënproduktit të eksportuar [18] tregon vlerën e eksporteve të kryera nga vetë zotëruesi i lejes së shfrytëzimit për muajin në të cilin deklarohet, të nënproduktit të prodhuar me mineralin që ky zotëruesi i lejes ka nxjerrë nga sipërfaqja/nëntoka, mbi bazën e çmimeve të eksportit, që është çmimi FOB Shqipëri.

19. Renta e llogaritur për mineralin e eksportuar [19], tregon vlerën e rentës që duhet të paguhet nga zotëruesi i lejes të shfrytëzimit për mineralin e papërpunuar, të eksportuar nga ana e tij për muajin për të cilin deklarohet, e cila rezulton duke shumëzuar vlerën e taksueshme [15] me % e rentës të miratuar për këto minerale, bazuar në shtojcën 2 të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 , i ndryshuar.

20. Renta e paguar për mineralin e eksportuar[20] tregon rentën e paguar në doganë për mineralin e papërpunuar, që zotëruesi i lejes nxjerr nga sipërfaqja/nëntoka dhe e eksporton ai vetë në muajin për të cilin deklarohet .

21. Renta e llogaritur për nënproduktin e eksportuar[21], tregon rentën që duhet të paguhet nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit për mineralin që ai vetë ka nxjerr nga sipërfaqja/nëntoka, dhe që e ka përdorur për prodhimin e nënproduktit të eksportuar nga ana e tij për muajin për të cilin deklarohet, dhe që rezulton duke shumëzuar vlerën e taksueshme [17] me % e rentës së miratuar për këtë mineral bazuar në shtojcën 2 të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 , i ndryshuar(si dhe në materialin e komisionit AD-HOC).

22. Renta e paguar për nënproduktin e eksportuar[22] tregon rentën e paguar në doganë për mineralin e përfshirë në nënproduktet e eksportuara nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit për muajin për të cilin deklarohet, (nënprodukte të cilat ai i ka prodhuar vetë me mineralin që ai vetë ka nxjerrë nga sipërfaqja/nëntoka).

23. Totali i rentës së llogaritur[23], tregon shumën totale të rentës që duhet të paguhet nga zotëruesi i lejes të shfrytëzimit, pra shumën e rentës së llogaritur për mineralin e eksportuar me rentën e llogaritur për nënproduktin e mineralit të eksportuar dhe është shuma e rubrikave [19]+ [21].

24. Totali i rentës së paguar[24] tregon shumën totale të rentës që është paguar në doganë nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit, pra shumën e rentës së paguar për mineralin e eksportuar me rentën e paguar për nënproduktin e mineralit të eksportuar dhe është shuma e rubrikave [20]+ [22].

III. Eksporte me të tretë

III/1. Shitje nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit tek eksportuesi, të mineralit të papërpunuar që zotëruesi i lejes nxjerr nga sipërfaqja/nëntoka me destinacion eksport, si dhe shitje nga zotëruesi i lejes të shfrytëzimit tek eksportuesi, të nënproduktit të prodhuar nga zotëruesi i lejes (me mineralin që ai ka nxjerrë nga sipërfaqja/nëntoka) me destinacion eksport. Shënim: Zotëruesi i lejes i cili nxjerr mineralin në këtë rast nuk është ai vetë eksportuesi i mineralit apo nënproduktit.

25. Vlera e taksueshme e mineralit [25] është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet % e rentës, që në rastin e shitjes së mineralit të papërpunuar nga zotëruesi i lejes tek eksportuesi, është e njëjtë me vlerën totale të shitjeve [26].
26. Vlera totale e mineralit [26] janë shitjet, brenda vendit, nga zotëruesi i lejes tek eksportuesi për muajin në të cilin deklarohet, mbi bazën e çmimeve të tregut brenda vendit, bazuar në faturat e shitjes me TVSH, të mineralit të papërpunuar të nxjerrë nga sipërfaqja/nëntoka nga zotëruesi i lejes.
27. Vlera e taksueshme e nënproduktit [27] është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet % e rentës, për nënproduktet e prodhuara nga zotëruesi i lejes të shfrytëzimit (me mineralin që ai vetë nxjerr nga sipërfaqja/nëntoka) të cilat ai i shet brenda vendit tek eksportuesi dhe që është vetëm vlera e mineralit të përdorur për prodhimin e këtyre nënprodukteve. Vlera deklarohet nga zotëruesi i lejes, mbi bazën e normativave teknologjike dhe çmimeve të mineralit të përfshirë në nënproduktin e shitur tek eksportuesi, i cili nuk duhet të jetë më i vogël se çmimi referues i përcaktuar në Raportin e Komisionit AD-HOC. Po ashtu normativat teknologjike mbi të cilat llogaritet minerali i përfshirë në nënprodukt nuk duhet të jenë më të ulta se ato të përcaktuara në raportin e komisionit AD-HOC.
28. Vlera totale e nënproduktit [28] janë shitjet brenda vendit, nga zotëruesi i lejes tek eksportuesi, për muajin në të cilin deklarohet, mbi bazën e çmimeve të tregut brenda vendit, bazuar në faturat e shitjes me TVSH të nënproduktit të prodhuar nga zotëruesi i lejes të shfrytëzimit.
29. Renta e llogaritur për mineralin [29], tregon rentën që duhet të paguhet nga zotëruesi i lejes të shfrytëzimit për mineralin e papërpunuar të shitur brenda vendit tek eksportuesi e cila del duke shumëzuar vlerën e tatueshme [25] me % e rentës të miratuar për këtë mineral bazuar në shtojcën 2 të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008, i ndryshuar.
30. Renta e llogaritur për nënproduktin [30], tregon rentën që duhet të paguhet nga zotëruesi i lejes të shfrytëzimit për mineralin që ai vetë ka nxjerr nga sipërfaqja/nëntoka, dhe që e ka përdorur për prodhimin e nënproduktit të shitur brenda vendit tek eksportuesi, e cila del duke shumëzuar vlerën e rubrikës [27] me % e rentës të miratuar për këtë mineral bazuar në shtojcën 2 të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008, i ndryshuar (si dhe në materialin e komisionit AD-HOC),.
31. Totali i rentës për t'u paguar [31], tregon shumën totale të rentës që duhet të paguhet nga zotëruesi i lejes të shfrytëzimit dhe është shuma e rubrikave [29]+ [30].

III/2. Eksporte nga eksportuesi i mineralit/nënproduktit që ai ka blerë brenda vendit nga zotëruesi i lejes të shfrytëzimit në përputhje me pikën III/1, të këtij udhëzuesi.

32. Vlera e taksueshme e mineralit [32] është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet % e rentës që është vlera totale e eksporteve të bëra nga eksportuesi për muajin për të cilin deklarohet i mineralit të papërpunuar të blerë nga zotëruesi i lejes të shfrytëzimit [33].
33. Vlera totale e mineralit [33] është vlera e eksportuar nga eksportuesi për muajin në të cilin deklarohet mbi bazën e çmimeve të eksportit, që është çmimi FOB Shqipëri, të mineralit të papërpunuar që ky eksportues ka blerë nga zotëruesi i lejes të shfrytëzimit.
34. Vlera e taksueshme e nënproduktit [34] është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet % e rentës, për nënproduktet e eksportuara nga eksportuesi, për muajin për të cilin deklarohet nënprodukte të cilat ai i ka blerë nga zotëruesi i lejes të shfrytëzimit. Baza e taksueshme llogaritet vetëm për vlerën e mineralit të përdorur për prodhimin e këtyre nënprodukteve. Vlera deklarohet nga eksportuesi, mbi bazën e normativave teknologjike dhe çmimeve të mineralit të përfshirë në nënproduktin e shitur tek eksportuesi, i cili nuk duhet të jetë më i vogël se çmimi referues dhe i përcaktuar në Raportin e Komisionit AD-HOC. Po ashtu normativat teknologjike mbi të cilat llogaritet minerali i përfshirë në nënprodukt nuk duhet të jenë më të ulta se ato të përcaktuara në raportin e komisionit AD-HOC.
35. Vlera totale e nënproduktit [35] tregon vlerën e eksporteve të bëra nga eksportuesi për muajin në të cilin deklarohet, mbi bazën e çmimeve të eksportit, të nënprodukteve të prodhuara dhe të blera nga zotëruesi i lejes.
36. Renta e paguar nga zotëruesi i lejes për mineralin me destinacion eksportin [36], tregon rentën që ka paguar zotëruesi i lejes tek drejtoria rajonale tatimore, për mineralin e papërpunuar të shitur tek eksportuesi brenda vendit për muajin për të cilin deklarohet. Renta e paguar nga zotëruesi vërtetohet nga eksportuesi në doganë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
37. Renta e paguar në doganë për mineralin [37] tregon rentën e paguar në doganë nga eksportuesi, për eksportin e mineralit të papërpunuar që ai ka blerë nga zotëruesi i lejes të shfrytëzimit. Renta e paguar në doganë del si rezultat i diferencës së mineralit të eksportuar të vlerësuar me çmimet e eksportit {rubrika [32]} shumëzuar me % e rentës të përcaktuar në ligj minus rentën e paguar nga zotëruesi i lejes për këtë sasi. Renta e paguar nga zotëruesi vërtetohet nga eksportuesi në doganë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
38. Renta e paguar nga zotëruesi i lejes për nënproduktin me destinacion eksportin [38], tregon rentën e paguar nga zotëruesi i lejes së shfrytëzimit tek drejtoria rajonale tatimore, për mineralin e përfshirë në nënproduktin që ka shitur tek eksportuesi për muajin për të cilin deklarohet. Renta e paguar nga zotëruesi vërtetohet nga eksportuesi në doganë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
39. Renta e paguar në doganë për nënproduktin [39] tregon rentën e paguar në doganë nga eksportuesi për mineralin e përfshirë në nënproduktet që eksporton, nënprodukte të cilat ai i ka blerë brenda vendit nga zotëruesi i lejes të shfrytëzimit. Renta e paguar në doganë del si rezultat i diferencës të rubrikës [34] shumëzuar me % e rentës të përcaktuar në ligj (si dhe në raportin e komisionit AD-HOC), minus rentën e paguar nga zotëruesi i lejes për këtë sasi minerali të përfshirë në nënproduktin që eksportohet. Renta e paguar nga zotëruesi vërtetohet nga eksportuesi në doganë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

40. Totali i rentës së paguar nga zotëruesi i lejes[40], tregon shumën totale të rentës të paguar nga zotëruesi i lejes të shfrytëzimit dhe është shuma e rubrikave [36]+ [38].
41. Totali i rentës së paguar në doganë [41] tregon shumën totale të rentës që paguhet në doganë nga eksportuesi dhe është shuma e rubrikave [37]+ [39].
42. Taksa e rentës minerare për t'u paguar[42] tregon shumën totale të rentës për t'u paguar nga zotëruesi i lejes të shfrytëzimit pranë drejtorisë rajonale tatimore dhe është shuma e rubrikave [14]+[31].
43. Dënime/interesa[43] janë dënime dhe interesa në përputhje me sanksionet të përcaktuara në ligjin nr. 9920/2008” Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- 44.Totali për t'u paguar[44] është shuma e rubrikave [42+43].

DREJTORIA RAJONALE E TATIMEVE

AKT-RAKORDIMI ME NJESITE VENDORE I PAGESES TE TAKSES TE RENTES MINERARE

Periudha Tatimore-----

Emri i Subjektit (zoterues i lejes)

NIPT

Adresa

Nr	Emertimi i mineralit nenproduktit	Prodhimi ne vlere	Njesia Respektive Vendore	Mineral, nenprodukt i shitur (000/lekë)		Mineral i perdorur per nenproduktin (000/lekë)		Taksa e paguar 000/lekë	Dokumenti i pageses nr. date	Renta e llogaritur njesise vendore
				Konsum final	Eksport	Konsum final	Eksport			
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11

Inspektori tatimor

(Emer Mbiemer)

Inspektori taksave vendore

(Emer Mbiemer)

Formulari nr. 9

DREJTORIA RAJONALE E TATIMEVE/DOGANAVE
TE DHENA MBI RENTEN E LLOGARITUR PER NJESITE E QEVERISJES VENDORE

Periudha Tatimore-----

Nr	Emertimi i subjektit	Njesia /te ku zhvillon aktivitet subjekti	Vlera e rentes minerare të derdhur gjate muajit (leke)
1	2	3	4

Drejtori i Drejtorise Rajonale

Date -----

Shënim Formulari nr. 9 plotesohet nga Drejtorite Rajonale Tatimore dhe te Doganave dhe dergohet
ne Ministrine e Financave brenda dates 30 të muajit pasardhese si permbledhese e formularit 7 te derguar nga tatimpaguesit

SHTOJCA Nr. 2
PËRQINDJA E RENTËS MINERARE SIPAS KLASIFIKIMIT

Nr.	Emërtimi i grupit të mineraleve sipas ligjit mineralar	Përqindja e rentës minerare
I	Grupi i parë (I) MINERALET METALIKE	
1	Mineralet e Argjendit	10
2	Mineralet e Arit	10
3	Mineralet e Bakrit	6
4	Mineralet e Kromit	6
5	Mineralet e Nikelit (nikel-silikat)	6
6	Mineralet e Hekurit (hekur-nikeli)	5
7	Mineralet Plumbit	5
8	Mineralet e Zinkut	7
9	Gjithë mineralet e tjera metalike	4
II	Grupi i dytë (II) MINERALET JOMETALIKE	
10	Të gjitha mineralet jometalike	4
III	Grupi i tretë (III) QYMYRET DHE BITUMET	
11	Qymyret	5
12	Bitumet	5
13	Rërat bituminoze	5
14	Reshpet naftore	5
15	Pirobitumet	6
IV	Grupi i katërt (IV) MINERALET DHE MATERIALET E NDËRTIMIT	
16	Graniti	6
17	Gëlqerorët	5
18	Gabrot	5
19	Bazaltet	4
20	Konglomerate	7
21	Mermeri	7
22	Pllakat e ndërtimit	7
23	Pllagjiogranitet	5
24	Ranoret	7
25	Serpentinitet	5
26	Travertinat	5
27	Traktolitet	5
28	Gjithë mineralet e tjera të grupit të katërt	5
V	Grupi i petë (V) GURËT E ÇMUAR	
29	Gjithë mineralet e grupit të pestë	10
VI	Grupi i gjashtë (VI) GURËT GJYSMË TË ÇMUAR DHE OPALI	
30	Gjithë mineralet e grupit të gjashtë	10
31	Grupi i shtatë (VII) NAFTA DHE GAZI	10